VENDIM
Nr.1040, datë 14.10.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1269, DATË 17.9.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE DETYRAT E PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE SHTETËRORE, TË NGARKUARA PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1269, datë 17.9.2008 të Këshillit të Ministrave, emërtimi "zëvendëskryeministri" zëvendësohet me "Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha